



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.982/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH "I..." me seli në Obiliq, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2172/19, të datës 14.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2172/19, të datës 14.06.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2172/19, të datës 14.06.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH "I..." me seli në Obiliq. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.06.2/596/2017 i datës 13.08.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTSH "I..." me seli në Obiliq, t'ia kthejë shumën prej 997.40€ (nëntëqind e nëntdhjetë e shtatë euro e katër dhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-16232 të datës 04.09.2017 të proceduar në Zyrës Doganore në Mitrovicë, me kamatë ligjore prej 85 duke filluar nga data e parashtimit të padisë në gjykatë 17.09.2019 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar A.nr.2172/19, të datës 14.06.2021ta prish si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të

nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.06.2/597/2017 i dates 14.06.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedure NTSH "I..." me seli në Obiliq, për rishqyrtimin e vendimit numër R-16232/04.09.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore në Mitrovicë.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 17.09.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.06.2/597/2017 i dates 14.06.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se gjykata e pranon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara e të drejta, dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor në pajtim me nenin 33 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se e paditura vetëm pse ka munguar kontrata ka refuzuar ankesën dhe këtë e konsideron të pa pranueshme, është interpretim i gabuar i gjykatës sepse kontrata paraqet pajtim të vullnetit dhe

elementet esenciale, si lëndën e saj dhe çmimin si element esencial për mallin e blerë. Pastaj, në bazë të analizimit të Dokumenteve Unike Doganore të deklaruara nga paditësi shihet se mallin në fjalë e ka deklaruar me çmim më të ulët dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar të dhëna për mallin në fjalë por me çmim më të lart se ai i deklaruar nga paditësi. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se e paditura me vendimin kontestues nuk ka dhënë arsye dhe prova konkrete se përse e ka kontestuar vlerën e mallit si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga paditësi, kur ka konsideruar se vlera e mallit lëndor e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin, me qëllim të importit në vendin tonë. Nga këto arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi në procedurën administrative tek e paditura por edhe në konflikt administrativ i ka paraqitur gjykatës provat për DUD-in R-16232/04.09.2017, pro faturën e blerjes së mallit me nr. 1/04.08.2017 të datës 04.08.2017 ku vlera e mallit është 6,700.00€ kun ë këtë profaturë është përfshirë edhe kaucioni në shumë prej 1,000.00€ apo gjithsejt shuma prej 7,700.00€ pastaj ka paraqitur faturën e blerjes së mallit me nr. 000409/08/2017 të datës 11.08.2017 ku vlera e mallit është 6,700.00€ ka paraqitur transaksionin bankar ndërkombëtar të datës 04.08.2017 në shumë prej 7,700.00€ me përshkrim të transaksionit “P... 2013, ..., blerja e veturës 6700€ dhe kaucion 1000”, dëshminë bankare të datës 08.09.2017, ku vërtetohet se paditësit i është kthyer nga eksportuesi kaucioni i paguar në shumë prej 970.00€, ndërsa vlera prej 30€ të njëjtit i është ndaluar në emër të provizionit bankar për transfertën hyrëse ndërkombëtare të paguar. Po ashtu paditësi ka paraqitur deklaratën eksportuese të datës 02.09.2017. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve importuese doganore, si pasojë e vlerësimit të mallit nga e paditura, nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe se kjo shumë u vërtetua nga gjykata me rastin e krahasimit të vlerës së detyrimeve importuese të llogaritur në DUDin e kontestuar, në versionin e rivlerësuar nga e paditura dhe të paraqitur nga paditësi tek e paditura përkatësisht vlera 3,540.50€-2,543.10€ ku rezulton vlera 997.40€, e cila paraqet shumën e detyrimeve doganore të paguar më shumë nga paditësi, si rezultat i rivlerësimit të mallit nga e paditura. Gjithashtu gjykata ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve që parashihet ti bashkëngjiten DUD-ave gjatë zhdoganimit të mallit, të cilat me të drejtë ka vlerësuar se provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore sa i përket vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimit gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimit u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.982/22, me datë 12.01.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami